

Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 19.05.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 18.05.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Commando SHPK" për aktivitetin: "Sigurimi fizik i objekteve të Komunes" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211 nxjerr:

V E N D I M

REFUZOHET kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Commando" e datës 18.05.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizik i objekteve të Komunes" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211 kundër *Njoftimit për Vendimin e AK-se të datës 13.05.2020*, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. **Vertetohet Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 13.05.2020 ;**
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Commando" me datë 18.05.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik i objekteve të Komunes" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211.

Autoriteti Kontraktues, me datë 19.05.2020 dhe ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimet tuaja janë të pa bazuara për arsyet në vijim:

-Konstatimi juaj se Autoriteti Kontraktues nuk ju ka ofruar çasje në dokumentet zyrtare është i pa bazuar për faktin se menjëherë pas pranimit u ak dorezuar materialet në formë elektronike, mirepo për shkak se fajlat kanë pasë shumë materiale nuk kanë arthur të gjitha tek ju. Edhe pas pranimit të kërkesës tuaj për rishqyrtim ju kemi ftuar që të vini fizikisht dhe të merrni të gjitha materialet ju e kini injoruar ftesën tonë, për arsyet që ju i dini;

-Pretendimi juaj se keni ofruar deshmi te mjaftueshme per vleren e referencave te kerkuara poashtu nuk eshte i bazuar per faktin se Vendimi i OSHP-se nuk i ka pranuar deshmite qe ne i kemi trajtuar si te pranueshme dhe bazuar ne kete vleresimi yne perfundimtar eshte bazuar ne ate Vendim dhe per kete arsye jeni trajtuar si tenderues i pa pergjegjshem dhe eshte refuzuar tenderi juaj.

-Pretendimet tuaja lidhur me dyshimet per pa pergjegjeshmerine administrative te tenderuesit te propozuar per dhenje te kontrates poashtu jane te pa qendrueshme,pasi qe i njejt i posedon te gjitha deshmitet e kerkuara nga Autoriteti Kontraktues.Poashtu ju sqarojme se eshte i pa bazuar pretendimi juaj se ky tenderues eshte eliminuar nga ky aktivitet,pasi qe Autoriteti Kontraktues nuk e ka eliminuar asnjehere te njejtin,por eshte trajtuar i pa sukseshem per shkak te çmimit total te parashikuar per 36 muaj mbi vleren e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues.

Bazuar ne konstatimet paraprake konstatoj se pretendimet tuaja jane te pa bazuara dhe kerkesa juaj refuzohet.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit